Oda e Stomatologëve të Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën Antropologjike Stomatologjike të Kosovës,

Organizon:

# KONFERENCËN E VII-TË NDËRKOMBËTARE TË STOMATOLOGJISË

**17-18 prill 2026 (Hotel Emerald, Prishtinë)**

**LIGJËRATA PLENARE**
Ligjërues vendor dhe ndërkombëtar nga Turqia, Italia, Brazili, Portugalia, Kroacia dhe Shqipëria. Ligjëruesit dhe programi i detajuar do të publikohet në web-faqe www.osk-ks.org dhe FB të OSK-së.

**Akreditimi:** Konferenca është akredituar nga Komisioni për EVP **me 20 pikë** për pjesëmarrje aktive dhe **15 pikë** për pjesëmarrje pasive.

**Regjistrimi**
Regjistrimi i pjesëmarrësve do të realizohet vetëm përmes **platformës digjitale** të OSK-së, dhe mosregjistrimi përmes platformës nuk është i vlefshëm.
Për pjesëmarrësit e regjistruar lëshohet certifikata elektronike nëpërmjet platformës digjitale.

| **Kuotizimi për pjesëmarrje** | **Regjistrimi (deri me 15 prill)** |
|---|---|
| Për stomatologët | **30 €** |
| Për teknikë dhe asistent dentar | **30 €** |

Pagesa bëhet përmes NLB Banka, Capital Ria apo transfer banker, duke u bazuar në këto të dhëna:
Emri i Llogarisë: Oda e Stomatologëve të Kosovës
Nr. Llogarisë: 1701 0016 0008 1756
Gjatë kryerjes së pagesës në bankë duhet të specifikohet emri dhe mbiemri i personit dhe emërtimi i pagesës: "Konferenca 2026". Pagesa me një transaksion mund të bëhet më së shumti për dy persona dhe duhet të specifikohet emri i secilit person.

**Ekspozitë**
Do të mbahet ekspozitë dentare. Për detajet rreth ekspozitës ju njoftojmë me kohë.

## SI TË PËRDORNI PLATFORMËN PËR REGJISTRIM PËR KONFERENCË

1. Hyni në platformën tuaj elektronike të OSK-së.

2. Zgjidhni modulin "Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)" (për më shumë, shihni foton).




3. Pasi të hapet moduli, klikoni "APLIKO PËR PJESËMARRJE" (shih foton).




4. Në hapin e radhës, klikoni butonin për aplikim/konfirmim të aplikimit (shih foton).



5. Te pyetja “A dëshironi të merrni pjesë në këtë event?”, zgjidhni “PO”.




6. Pasi të zgjidhni “PO”, në emailin tuaj do të pranoni një email konfirmimi për kërkesën e regjistrimit, së bashku me detajet e pagesës për pjesëmarrje (shih foton).



I/E nderuar [redacted]

Kërkesa juaj për regjistrim të pjesëmarrjes në aktivitetin e EVP-së [redacted] është pranuar.

Ju lutem që në llogarinë banakare të organizatorit të aktivitetit [redacted] të bëni pagesën e pjesëmarrjes në shumën [redacted]

Dëshmia e pagesës dërgohet në emailin zyrtar të organizatorit [redacted]

Pas pranimit të dëshmisë të pagesës, organizatori do të shqyrtojë kërkesen për regjistrim.

Me respekt,

Organizatori i aktivitetit

*Ky është email i automatizuar, ju lutemi të mos ktheni përgjigje në këtë email.*

7. Pasi ta keni realizuar pagesën dhe ta keni dërguar dëshminë e pagesës në emailin e kërkuar, administrate e OSK-së do ta konfirmojë regjistrimin tuaj. Me këtë rast, do të pranoni një email konfirmimi të regjistrimit (shih foton).



**Njoftim për vendimin e ngjarjes**

**I/e nderuar, [redacted]**

Kërkesa juaj për regjistrim të pjesëmarrjes në aktivitetin e EVP-së "Test event" është aprovuar.

Me respekt,
Organizatori i aktivitetit

**Shenim:** Pjesëmarrja e juaj fizike në Konferencë është e obligueshme, dhe ajo do të evidentohet nëpërmjet verifikimit me *QR code* përmes celularit tuaj, ditën e mbajtjes së Konferencës.

Për informata të tjera mund të kontaktoni në numrin **045 240 588** ose përmes **odastomatologjike@gmail.com**